



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:017709
Datë: 18.03.2024
Numri i dokumentit: 05460936

KF.nr.1053/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me Gjyqtaren Vera Gashi Bala, në çështjen juridike të paditësit A.V., nga Vinterthur-Zvicër, të cilin me autorizim e përfaqëson E.H.V. avokate në Ferizaj, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim vendimi, jashtë seancës, me datë 15.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë/Departamenti Fiskal SHPALLET JO KOMPETENT në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas padisë, të ushtruar nga paditësi A.V. nga Vintherthur-Zvicër.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, lënda së bashku me shkresat e saj, i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Administrative.

A r s y e t i m

Paditësi A.V., përmes përfaqësuesit të autorizuar, E.H.V., me datë 09.12.2022 ka ushtruar padi në këtë gjykatë me të cilën ka kërkuar anulimin e aktvendimit nr. 03.1.7-2022-1587 të datës 07.11.2022 të lëshuar nga Sektori për Kundërvajtje Doganore, dhe aktvendimit me nr. 01.3.2.2/23436 të datës 22.11.2022 të lëshuar nga organi i shkallës së dytë, Komisioni për Rishyrtim të Ankesave.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë, e në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së si dhe nenet 11, par. 2 dhe 13 të ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, shqyrtoi kompetencën lëndore të Gjykatës në këtë çështje juridike dhe vlerësoi se Dhomat e Shkallës së

Parë/Departamenti Fiskal i Gjykatës Komerciale, nuk është kompetente në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë lëndë.

Për të vlerësuar kompetencën, Gjykata fillimisht iu referua Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, e i cili ligj në nenin 11, paragrafi 2, përcakton se *“Dhomat e Shkallës së Parë janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet në juridiksionin e Gjykatës Komerciale”*, dhe nenit 13, par 4 me të cilin taksativisht përcaktohet se *“Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafin 1.11 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti Fiskal”*.

Gjykata, vlerësimin se kjo çështje nuk bie në kompetencë të Departamentit Fiskal të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, e ka bazuar në atë se, paditësi nuk e gëzon cilësinë e ndonjë shoqërie tregtare, por ka cilësinë e personit fizik.

Kompetenca e Departamentit Fiskal është e rregulluar me nenin 13 paragrafi 1.11 të Ligjit nr.08/L019 për Gjykatën Komerciale, me të cilin shprehimisht është përcaktuar se Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së parë - Departamenti Fiskal është kompetent për të vendosur për: *“kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare të Administratës Tatimore, Autoriteteve Doganore, Ministrisë së Financave dhe çdo organi tjetër publik përgjegjës për vendosjen e tatimeve ose detyrimeve të tjera shtetërore;”*

Ndërsa, përkufizimin e shoqërive tregtare shprehimisht e përcakton neni 3 par 1.22 i Ligjit Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare, sipas të cilit: *“Shoqëria Tregtare është term i përgjithshëm që do të thotë dhe përfshin çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas këtij ligji apo të një ligji tjetër siç është përcaktuar në nenin 5 paragrafi 3 i këtij ligji, duke përfshirë bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare”* . Tutje neni 5 par 3 i të njëjtit ligj përcakton se: *“Me ligj të veçantë mund të përcaktohen edhe forma të tjera të organizimit të Shoqërive Tregtare ose subjekte të tjera që kërkohet të regjistrohen në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve. Forma e organizimit si dhe të drejtat dhe detyrimet e të gjitha palëve në këto shoqëri tregtare ose subjekte të tjera rregullohen në ligjin përkatës më të cilin krijohet Shoqëria Tregtare ose subjekti përkatës. Dispozitat e ligji të veçantë që rregullojnë këto shoqëri tregtare ose subjekte të tjera,*

duke përfshirë dispozitat e ligjit në fuqi për ndërmarrjet publike, kanë përparësi ndaj dispozitave të këtij ligji”. Ndërsa llojet e Shoqërive Tregtare janë të përcaktuara me nenin 5 par 1 të po të njëjtit, sipas të cilit: *“Një Shoqëri Tregtare mund të themelohet në Kosovë si Biznes Individual, Ortakëri e Përgjithshme, Ortakëri e Kufizuar, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar ose Shoqëri aksionare”, ndërsa me par 3 përcaktohet se “Me ligj të veçantë mund të përcaktohen edhe forma të tjera të organizimit të Shoqërive Tregtare ose subjekte të tjera që kërkohet të regjistrohen në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve. Forma e organizimit si dhe të drejtat dhe detyrimet e të gjitha palëve në këto shoqëri tregtare ose subjekte të tjera rregullohen në ligjin përcaktës më të cilin krijohet Shoqëria Tregtare ose subjekti përkatës. Dispozitat e ligjit të vecantë që rregullojnë këto shoqëri tregtare ose subjekte të tjera, duke përfshirë dispozitat e ligjit në fuqi për ndërmarrjet publike, kanë përparësi ndaj dispozitave të këtij ligji.”*

Në rastin konkret, paditësi A.V., nuk gëzon cilësinë e asnjërës prej këtyre llojeve të shoqërive tregtare, e as të ndonjë shoqërie tjetër tregtare të paraparë me ndonjë ligj të veçantë.

Rrjedhimisht, Dhomat e Shkallës së Parë/ Departamenti Fiskal i Gjykatës Komerciale, duke u bazuar në nenet 19, dhe 23, par 1, të LPK-së, si dhe neneve 11, par 2, 13, par 1, nën par. 1.11, dhe par. 2 të këtij neni të Ligjit mbi Gjykatën Komerciale 08/L-015, konstatoi që kjo çështje juridike nuk bie në kompetencën lëndore të kësaj gjykate.

Nga të cekurat më lart e konform Nenit 387.1 pika (u) dhe Nenit 392 pika (b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.1053/22, datë 18.03.2024

G j y q t a r j a
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, Dhomave të Shkallës së Dytë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.